



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritim Evropian

Mbledhja nr. 27.

Prishtinë, më 16.10.2018, në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu-Kodra, Armend Zemaj, Fikrim Damka, Ismajl Kurteshi, Fatmire Kollçaku, Visar Ymeri, Ilir Deda, Zenun Pajaziti dhe Milaim Zeka.

Munguan: Donika Kadaj-Bujupi dhe Adem Hoxha.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli dhe Safet Beqiri.

Pjesëmarrësit e tjerë: Përfaqësuesit nga KDI dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi, Blerta Deliu-Kodra, kryetare e komisionit.

Kryetarja, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen e komisionit me këtë:

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 02.10.2018;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-054 për gjykatat, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-079 për efikasitetin e energjisë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 05/L-132 për automjete, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-033 për produkte të ndërtimit, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua, i pa ndryshuar.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 02.10.2018.

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-054 për gjykatat, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja, lidhur me këtë projektligj, paraqiti opinionin ligjor, sa i përket legjislacionit të BE-së, pra fushën që e mbulon Projektligji për gjykatat nuk është e rregulluar në mënyrë specifike me legjislacionin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian, dhe si e tillë, kjo fushë është në kompetencat e brendshme të shteteve anëtare të BE-së, që ta rregullojnë përmes politikave të tyre të brendshme, andaj konstatohet se dispozitat e këtij projektligji nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së, përkatësisht me *Acquis*, andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Kryetarja hapi diskutimin dhe e hodhi në votim.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-054 për gjykatat, me amendamentet e Komisionit funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së, përkatësisht me *Acquis*, andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor lidhur me këtë projektligj, duke konstatuar se Projektligji së bashku me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së, përkatësisht me *Acquis*, sepse kjo fushë është e rregulluar përmes politikave të brendshme kombëtare të shteteve anëtare të BE-së, nuk është e rregulluar në mënyrë specifike me legjislacionin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian.

Në vazhdim, hapi diskutimin dhe e hodhi në votim projektligjin, së bashku me amendamente.

Pas votimit, **kryetarja** konstatoi se komisioni, me shumicë votash, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së, përkatësisht me *Acquis*, sepse kjo fushë është e rregulluar përmes politikave të brendshme kombëtare të shteteve anëtare të BE-së.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-079 për efikasitetin e energjisë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor, duke konstatuar se projektligji, së bashku me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së, si dhe janë pjesërisht në përputhje me *Acquis* të BE-së.

Më pas, hapi diskutimin dhe e hodhi në votim projektligjin, së bashku me amendamente.

Pas votimit, **kryetarja** konstatoi se komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-079 për efikasitetin e energjisë, me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe pjesërisht në përputhje me *Acquis* të BE-së.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 05/L-132 për automjete, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor, duke konstatuar se dispozitat e këtij projektligji, së bashku me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së, si dhe janë pjesërisht në përputhje me *Acquis* të BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Andaj, lidhur me këtë Projektligj, hapi diskutimin.

Visar Ymeri, tha se në amendamentin 1 të Komisionit funksional, që ka të bëjë me vjetërsinë e importit të automjeteve, ndryshimi që është bërë, mund të jetë në shpërputhje me standardet evropiane. Në ligj thuhet se në Kosovë nuk mund të importohen veturat më të vjetra se 10 vjet dhe nuk e plotësojnë standardin minimal Euro 4, kurse tani është ndryshuar me amendamentin e ri, ku thuhet se në Kosovë nuk mund të importohen vetura më të vjetra se 15 vjet. Ne tani duhet shikuar në dritën e standardeve evropiane, nëse këto dy kufizimet, njëra në standard e tjetra në kohë apo amendamenti e ndryshon atë në standard, nëse e ndryshon në standard, atëherë mendoj se është në shpërputhje me zhvillimet në BE, sa i përket kësaj çështjeje, që është shumë e rëndësishme, sepse një prej ndotësve kryesor të mjedisit, janë makinat që i përdorim dhe këtu duhet të jemi shumë të kujdesshëm.

Zenun Pajaziti, tha se padyshim, ndoshta është pika kyçe, me të cilën është iniciuar ky plotësim- ndryshim i këtij ligji. Ka pasur një debat edhe në seancë dhe padyshim do të ishte e padrejtë që mos të zhvillohet drejt ky debat, deri në fund, dhe të merret një vendim i duhur. BE-ja i ka tejkaluar disa norma për faktin që këto kanë qenë shumë vite të rregulluara dhe brenda BE-së ka diçka krejt tjetër dhe këto janë sfida të vendeve që aderojnë në BE. Pra, me këtë plotësim- ndryshim nuk është se i afrohem standardeve të BE-së. Ky amendament, në njëfarë mënyre, më shumë iu përshtatet grupeve të interesit, sepse në njërin anë thuhet se qytetarët të kenë mundësi të blejnë vetura me lirë, por në anën tjetër e dëmton rëndë ambientin. Mendoj se është shumë serioze, grupet politike duhet të kenë edhe përgjegjësi politike në miratim të këtij projektligji.

Milaim Zeka, tha se ky amendament, konkretisht është propozuar nga Mërgim Lushtaku. Unë, këtu në komision dhe në seancë, do ta kundërshtoj fuqishëm, pasi që konsideroj se ky amendament është bërë vetëm për të përfutur vota prej fukarenjve, por ne nuk bëjmë ligje për mandate tona e as për një afat të caktuar. Ne po shohim se shumë qytete të BE-së i kanë ndaluar makinat dizel.

Tani, ne nuk mund të sjellim llomin e Evropës këtu dhe mendoj se nuk është në përputhje me standardet e BE-së dhe duhet të ndryshohet. Pyes anëtarët, ne si komision a mund ta kthejmë prapa këtë ligj dhe mos ta dërgojmë në seancë?

Armend Zemaj, tha se është e vërtetë se ka pasur debat sa i përket kësaj norme, interesat janë të ndryshme, deputetët kanë të drejtë të propozojnë dhe kanë të drejtë edhe të përfaqësojnë, qoftë edhe grupe të ndryshme të interesit dhe është normale deri sa nuk bie me interesin e përgjithshëm, nëse interesi i përgjithshëm derivon nga Rezoluta që e ka nxjerrë Kuvendi, është dashur që të jetë temë edhe mbrojtja e ambientit, sa i përket importit të veturave të vjetra. Pra, nuk është interesi vetëm i qytetarëve që blejnë makina me çmime më të ulëta, por është edhe interesi i atyre që merren me importin e veturave.

Ne, proceduralisht jemi pak të hendikepuar, sipas Rregullores së Kuvendit, sepse ne japim vendim këtu për përkrahje apo mospërkrahje me legjislacionin e BE-së, por nëse

nuk e përkrahim, atëherë ne duhet ta japim arsyetimin, por prapë në brendësinë e arsyetimit, jemi të hendikepuar, duke i marr parasysh direktivat e BE-së, sepse nëse një direktivë nuk e ndalon vjetërsinë e importit, ndërsa e ndalon atë që u tha për ndotjen e mjedisit, tash do të thotë se brenda kritereve tjera të ligji për automjete, duhet të jenë kriteret se çfarë norme e gazit lejohet dhe sa është Euro 4 në brendësi të saj, sepse nëse sillet vetura 15 vite e vjetër, domosdoshmërisht duhet t'iu nënshtrohet kushteve të potencuara. Temë tjetër është se ne kemi një monopol të homologimit dhe monopol të koordinuar të atyre që e bëjnë kontrollin teknik dhe këto janë çështje tjera, që janë fushëveprimtari më e gjerë. Personalisht, nuk e kam përkrahur dhe kam qenë i rezervuar mes asaj që të krijohet mundësi e importit, pa kufizim, por brenda saj të ketë procedura strikte të këtyre kushteve dhe kritereve, sepse vetë mundësia për kufizim po jep mundësi të keqpërdorimit, qoftë në import, qoftë të institucioneve që janë përgjegjëse.

Është një problematikë pak më e madhe por në fushën tonë, besoj se nuk është aq imediate që kjo të përcillet, me një konsultim të Komisionit funksional dhe me një qartësim edhe me Ministrinë e Ambientit, se a është pjesë e rekomandimeve të Kuvendit të Kosovës mbrojtja e ambientit, sepse nëse ne e kemi futur në rezolutë, atëherë po shfaqet logjika që në Kuvendin e Kosovës, rezolutat janë sa për sy e faqe dhe asnjë rekomandim i saj nuk gjen implementim në institucionet e Republikës së Kosovës.

Ismajl Kurteshi, tha se natyrisht që ne kur i miratojmë ligjet, i kemi parasysh interesat e qytetarëve dhe grupeve të caktuara, por konsideroj se ky ligj të mbetet ashtu si është dhe mos të rriten vitet e vjetërsisë për t'i importuar veturat, sepse edhe ata që kanë interesa të drejtpërdrejta financiare atakohen nga pasojat e ndotjes së ajrit. Ky ligj edhe pse nuk bie ndesh me ligjet evropiane, bie ndesh me standardet evropiane dhe kjo është e mjaftueshme ta shprehim mendimin tonë, se ne nuk jemi për ndryshimin e këtij ligji, në pikën ku parashihet që vitet e vjetërsisë së automjeteve të shtohen.

Fatmire Kollçaku, tha se me këto ndryshime do të shënohet regres, jo vetëm si anëtare e komisionit, por edhe si mjeke, jam e shqetësuar me statistikat për ndotjen e ajrit dhe nuk mund t'ia lejojmë vetes të bëhemi kontejner i Evropës, çka mund të bëjmë që në të ardhmen t'iu mundësojmë qytetarëve që me kamata shumë më të ulëta, të kenë qasje te veturat e reja e jo të mundësojmë importimin e veturave të vjetra, që Evropa nuk ka ku t'ia lërë, kurse ne do ta ndotin ambientin edhe më shumë.

Andaj, mendoj se nuk duhet t'ia japim rekomandimin kundër këtij plotësim-ndryshimi të këtij ligji.

Visar Ymeri, tha se ky komision duhet parë rolin dhe kompetencën e komisionit më gjerë. Komisioni ynë nuk duhet të jetë vetëm një lloj trajtuesi dhe krahasuesi teknik i përputhshmërisë së ligjeve tona me ligjet e BE-së, sepse ka shumë gjëra, që për shkak të stadi të zhvillimit, të cilat janë, në vendet në BE, rregullohen ndryshe dhe ka shumë gjëra që nuk rregullohen, sepse nuk ka nevojë, por kjo nuk do të thotë që nuk ka një standard ose frymë të rregullimit të çështjeve të caktuara në BE e që nuk është e

kodifikuar me ligj. Në këtë drejtim, konsideroj se ne, si komision, duhet gjithsesi, kur t'i shqyrtojmë ligjet, ta kemi parasysh, së pari Acquis communitare, si bazë e pastaj edhe vërejtjet që na vijnë prej raporteve për vendin, dhe në përgjithësi, në tërë diskutimin e dokumentit që prodhohen në këtë marrëdhënie, që e ka Kosova me BE-në, ato janë të vlefshme njëjtë për ne, aq sa janë edhe ligjet që e përbëjnë Acquis communitare.

Nëse ne kemi vërejtje të vazhdueshme për nivelin e mbrojtjes së mjedisit dhe rrezikun nga ndotja, në secilin raport për vendin, atëherë ne duhet ta marrim parasysh kur flasim për çështjet, të cilat e dëmtojnë mjedisin në Republikën e Kosovës, siç është çështja që po flasim tani.

Andaj, ne duhet ta diskutojmë këtë çështje, në drejtim të diskutimit, dhe duke qenë kështu, ne si komision, në këtë rast, krejt çka mundemi të bëjmë është nëse të gjithë jemi dakord të rekomandojmë mosvotimin e këtij projektligji, për shkak të këtij amendamenti dhe pastaj seanca vendos.

Kryetarja njoftoi se në ndërkohë ishte njoftuar se Komisioni funksional po e zhvillon mbledhjen tani, andaj ndoshta do të ishte mirë që ta shtyjme mbledhjen dhe ta mbajmë një mbledhje të përbashkët me komisionin funksional dhe ta ftojme edhe ndonjë përfaqësues të ministrisë, që mos të na ndodh si me ligjin për shërbimet postare ku pastaj kanë dalë disa amendamente nga komisioni ynë.

Milaim Zeka, pajtohet me diskutimin e deputetit Ymeri, kur diskutoi për rolin e komisionit, sepse Komisioni për Integritet nuk është vetëm urë kaluese për ligjet që na i sjellin, që ne vetëm t'i ngremë gishtat, për t'i miratuar ligjet. Pra, kur është çështja e miratimit të ligjeve, duhet pasur kujdes ndaj disa burokratëve të Zyrës së BE –së, sepse ata paguhen për kryerjen e punës së vet, por edhe ne duhet ta kryejmë punën tonë, si deputetë. Në 25 vende të BE-së, p.sh. shpifjen e konsiderojnë si vepër penale dhe dënohet, kurse neve na kanë detyruar dhunshëm për të hequr shpifjen prej Kodit Penal dhe mos të ndiqet penalisht një person që mund të shkruajë gjithçka, çka t'i tekton, pra të shkruajë ndaj një personi tjetër.

Ne e dimë se këto standarde të shumëfishta të BE-së janë hedhur edhe në kurrizin e deputetëve.

Ismajl Kurteshi, mendon se pavarësisht si votojnë komisionet tjera dhe si mendojnë ministrinë, ne duhet të votojmë në atë frymë që po besojmë se është e drejtë për ne, pra është që të votojmë kundër këtij amendamenti.

Ilir Deda, tha se jemi duke e zgjatur pakëz, sepse udhërrëfyes për ne duhet të jetë rezoluta, të cilën e kemi votuar në fillim të këtij viti, dhe ai që e ka propozuar këtë projektligj, e ka votuar rezolutën që është në kundërshtim me këtë projektligj.

Nëse ju kujtohet, i kemi dhënë udhërrëfyes dhe kërkesa financiare e Qeverisë së Kosovës, ata e kanë një plan dyvjeçar prej Kuvendit, se çka duhet bërë për përmirësimin e ambientit.

Propozoj që të ftohet Komisionin funksional dhe t'iu thuhet se kjo që jeni duke bërë, është shkelje e rezolutës që e kemi votuar dhe le ta tërheqin, por nëse shkon në seancë, ne duhet të jemi njëzëri dhe mos të lejojmë që ky ligj të kalojë.

Visar Ymeri, tha se Komisioni funksional është duke mbajtur mbledhje për këtë çështje, por si duket nuk ka kuorum për të votuar, nëse Komisioni funksional e ka ende në diskutim projektligjin, ende kanë shans të ndryshohet, dhe nëse ata e ndryshojnë, ne prapë e diskutojmë tekstin e ndryshuar, por nëse nuk e ndryshojnë, ne veç jemi deklaruar kundër.

Fikrim Damka, tha se mandati i komisionit është që të shikohet se a ka pajtueshmëri ligji apo jo dhe pastaj seanca vendos. Në këtë rast, pasi neve në komision na ka ardhur raporti me rekomandime, ky raport është final dhe ne duhet të dalim me rekomandim.

Kryetarja, pas diskutimeve, tha se tani i kemi dy opsione, ose të kërkojmë sqarime shtesë nga komisioni funksional, ose ta votojmë se nuk e përkrahim amendamentin, i cili ka të bëjë me vjetërsinë e automjeteve.

Zenun Pajaziti, vlerësoi se në këtë rast, është më mirë të bëhet një votim, për ose kundër, në seancë plenare të jepet një sqarim, pse ka vendosur Komisioni për Integritet Evropian kundër, vendosja në një pjesë që duhet respektuar një standard i caktuar, në njëfarë mënyre, po e arsyeton zgjatjen e vjetërsisë. Në rastin tonë konkret, edhe rezoluta e miratuar që u përmend, është pikërisht pse ne nuk kemi mekanizma të bollshëm për një rregullim të kësaj fushe në aspektin teknik, prandaj e kemi ambientin keq, përndryshe është keq mos që mos t'iu mundësohet njerëzve të blejnë makina, kudo qofshin ato, por me standarde të mira teknike, prandaj ne duhet të jemi të pjekur mjaftueshëm politikisht për të vendosur. Unë jam që mos të kalojë ky amendament.

Kryetarja theksoi se në bazë të asaj që u tha, secili nga dimensionet e vet është duke e kundërshtuar, por nëse Komisioni funksional nuk ka kuorum dhe nuk arrin sot të marrë vendim përfundimtar për këtë çështje, unë jam që t'i drejtohem Komisionit për Zhvillim Ekonomik dhe të kërkojmë që të rishikohet edhe një herë, me vërejtjet tona.

Armend Zemaj, pavarësisht çka kanë pasur në takim sot, është problem i tyre. Esenca është se ata sipas Rregullores së punës kanë kërkuar raport nga 4 komisionet e përhershme dhe puna për ta ka përfunduar, dhe me rekomandimet e këtyre komisioneve, përcillet projektligji për seancë. Po ashtu, propozoj që komisioni të votojë kundër amendamentit 1, ose të hedhet në votim, në tërësi, nuk po e paragjykoj rezultatin dhe pastaj ai vendim shkon në seancë plenare, pastaj kryetarja e komisionit e paraqet arsyetimin.

Kryetarja propozoi t'i hedhë në votim dy propozimet.

Visar Ymeri, tha se nuk kemi të bëjmë me dy propozime, por një vendim i cili ka dy forma.

Unë jam dakord që ne sot të votojmë në Komision dhe ta marrim një vendim por mund të marrë dy forma.

1. Ne po e votojmë sot dhe nëse nuk ka ndryshime nga Komisioni funksional, automatikisht të dërgohet për seancë plenare.
2. Por nëse në ndërkohë nuk e kanë përfunduar punën, ne mund t'i dërgojmë Komisionit funksional si vërejtje, për të marrë parasysh se ne jemi kundër këtij formulimi të amendamentit dhe votojmë kundër.

Ismajl Kurteshi, tha se në të votojmë sot, se jemi kundër dhe nëse ata vendosin ta ndryshojnë tekstin, atëherë ata le të kërkojnë rishqyrtim, sepse nga përvoja ime që e kam në Kuvend, në 4 komisionet kryesore dërgohet në shqyrtim vetëm versioni final.

Kryetarja theksoi se ne mund t'i propozojmë Komisionit funksional, që nëse nuk rishikohet amendamenti 1 dhe projektligji në tërësi, Komisioni funksional do të votojë kundër.

Pas diskutimeve, kryetarja e hodhi në votim projektligjin me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional dhe konstatoi se komisioni, me shumicë votash, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk miratohet nga komisioni.

Arsyetimin e rekomandimit do ta paraqesë kryetarja e komisionit, në seancë plenare.

Të ndryshme

- 7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-033 për produkte të ndërtimit, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

Kryetarja, lidhur me këtë projektligj, tha se çështjet e rregulluara dhe të adresuara nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së.

Po ashtu, hapi diskutimin dhe pas votimit, konstatoi se komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-033 për produkte të ndërtimit, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë mund të rekomandohet për miratim në seancë plenare.

- 8. Të ndryshme**

Kryetarja njoftoi se është pranuar një kërkesë nga Komisioni për Çështje Evropiane i Kuvendit të Kroacisë për një vizitë, jemi në përgatitje të një agjende, si data të mundshme janë 22-23 tetor dhe jemi në pritje të konfirmimit.

Milaim Zeka, kërkoi mbështetje nga të gjithë anëtarët e komisionit, lidhur me propozimin e tij për një rezolutë për mbrojtjen e imunitetit të deputetit, rezolutë e cila do të mbrojë autoritetin, personalitetin dhe dinjitetin e deputetit. Në vazhdim, tha se në Rregulloren e Kuvendit, thuhet tekstualisht se kur mund të arrestohet një deputet, në çfarë rrethanash dhe prokurori i shtetit duhet të marrë leje nga Kryetari i Kuvendit dhe pastaj në bazë të Rregullores, Kryetari duhet të kërkojë sqarime nga prokurori i shtetit, pse është arrestuar deputeti.

Kam pasur takim me Kryetarin e Kuvendit, për këtë çështje, arsyetimi i Kryetarit të Kuvendit ishte, pasi unë nuk kam kërkuar një gjë të tillë për deputetët e Vetëvendosjes, tash nuk mund të kërkojë edhe për ty. Pra, këtu faji dhe dënimi është kolektiv. Kushdo që është arrestuar prej deputetëve, reagimi i deputetëve është dashur të jetë kolektivë, sepse mbrohet dinjiteti i deputetit, dhe mbi bazën e kësaj, do të paraqesë një rezolutë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për t'u qartësuar kjo. Po ashtu, kisha pasur dëshirë të kemi një bashkëpunim me të gjitha partitë parlamentare, që ta bëjmë një pyetje, se jemi apo nuk jemi deputetë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:25.

Përgatitur nga:
Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetare e komisionit,
Blerta Deliu- Kodra
